



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDIM

Nr. 15, datë 8.11.2019

**PËR MIRATIMIN ME MIRËKUPTIM TË KALENDARIT 3 JAVOR TË PUNIMEVE
TË KUVENDIT DHE KALENDARIT TË VEÇANTË TË PROJEKTLIGJIT
PËR BUXHETIN E VITIT 2020 DHE PROJEKTLIGJEVE FINANCIARE
QË KANË LIDHJE ME TË NË MBLEDHJEN
E KONFERENCËS SË KRYETARËVE, DATË 8.11.2019**

Në mbështetje të neneve 12, 27 dhe 79 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

I. Miratohet me mirëkuptim Kalendar 3-javor i Punimeve të Kuvendit për periudhën 25 nëntor – 19 dhjetor 2019, me propozimet e bëra në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve dhe i përcillet Kuvendit për njoftim në seancën plenare të datës 11.11.2019.

II. Miratohet me mirëkuptim kalendar i veçantë i projektligjit të buxhetit për vitin 2020 dhe i projektligjeve financiare që kanë lidhje me të me ndryshimet e propozuara në mbledhje dhe i përcillet Kuvendit për njoftim në seancën plenare të datës 11.11.2019.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz Ruçi

